



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I NDIHMËS DHE KOORDINIMIT TË INFORMACIONIT

Nr. 370/3 Prot.

Tiranë, më 05.03.2026

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 1402/48 PROT., DATË 23.01.2026 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR PËRFUNDIMIN E HETIMIT DISIPLINOR NDAJ ISH-MAGJISTRATIT ZOTIT T.S., ME DETYRË GJYQATAR I GJYKATËS SË APELIT SHKODËR NË KOHËN E SHKELJES SË PRETENDUAR”

Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 1402/48 prot., datë 23.01.2026 ka vendosur përfundimin e hetimit disiplinor, të nisur mbi bazë ankese të disa ankuesve dhe iniciativën e tij, ndaj ish-magjistratit T.S., me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit, Shkodër, në kohën kur shkeljet e pretenduara kanë ndodhur. Bazuar në nenin 133 dhe 134 pika 1 shkronja “ç” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 194 dhe nenin 214 pika 7, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka vendosur përfundimin e hetimit disiplinor. Referuar nenit 134, vendimi duhet t’i njoftohet ish-magjistratit brenda 5 ditëve, i cili i jep të drejtën e ankimit në Këshillin e Lartë Gjyqësor, sipas afateve të përcaktuara në ligj.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e deklaruar nga magjistrati, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Shkodër, sipas adresës së deklaruar nga T.S., Rruga “Tom Kola”, ndërtesa nr. 297, Shkodër;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

